



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 219

Tiranë – E enjte, 14 dhjetor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 745, datë 13.12.2017	Për shpërblimin e pensionistëve për festat e fundvitit, 2017..... 11767
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 746, datë 13.12.2017	Për shpërblimin e disa kategorive të veçanta për festat e fundvitit, 2017..... 11768
Vendim i Komisionit Shtetëror për organizimin e veprimtarive, në kuadër të “Vitet Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut”, nr. 2, datë 11.12.2017	Për miratimin e logos kombëtare në kuadër të “Vitet Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut”, së bashku me shkrimin “Viti Mbarëkombëtar i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut-2018”..... 11768

**VENDIM****Nr. 745, datë 13.12.2017****PËR SHPËRBLIMIN E PENSIONISTËVE
PËR FESTAT E FUNDVITIT, 2017**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimin, në masën 3 000 (tre mijë) lekë, të personave, sipas kategorive të mëposhtme:

a) Personat që marrin pension pleqërie, pension invaliditeti, pension familjar dhe pension social, sipas ligjeve nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) Personat që marrin pension, sipas ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe sipas paragrafit të katërt, të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

c) Personat që marrin trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 8685, datë 22.6.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të ndryshuar, dhe personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar;

ç) Personat që marrin pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

d) Personat që marrin pension pleqërie, sipas ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”;

dh) Personat që nuk përfitojnë pension, por që trajtohen vetëm me shpërblimin financiar si veteranë të LANC-it, sipas vendimit nr. 190, datë 3.5.1995, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar””, si dhe personat të cilët marrin vetëm pension të posaçëm për merita të veçanta, sipas dispozitave të ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”.

2. Të drejtën për të përfituar shpërblimin në masën e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, e kanë edhe ata persona që kanë datë të fillimit të pensionit, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të llogaritura në shumën 1 960 000 000 (një miliard e nëntëqind e gjashtëdhjetë milionë) lekë, të përballohen nga buxheti i sigurimeve shoqërore, i miratuar për vitin 2017, të cilat ndahen: 1 948 milionë lekë për dhënien e shpërblimeve dhe 12 milionë lekë për pagesën e komisioneve të shërbimit për pagesën e shpërblimeve.

4. Shpërblimet të kalohen në llogaritë e pensionistëve në muajin dhjetor 2017 dhe të paguhen gjatë këtij muaji. Në rastet kur pagesat efektive nuk kryhen brenda muajit dhjetor 2017, ato të paguhen gjatë vitit të ardhshëm.

5. Procedura e pagesës dhe e administrimit të shpërblimit për pensionistët të realizohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a.

6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 746, datë 13.12.2017****PËR SHPËRBLIMIN E DISA
KATEGORIVE TË VEÇANTA PËR
FESTAT E FUNDVITIT, 2017**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 13 e 18, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfituesit nga skema e ndihmës ekonomike dhe paaftësisë përfitojnë kompensimin financiar në masën 2 000 (dy mijë) lekë, të ndarë sipas këtyre kategorive:

a) Familje, të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike;

b) Familje, të cilat kanë në përbërje të tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të KMCAP-së, sipas pikës 3, të nenit 7, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar;

c) Individë, përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar;

ç) Individë, përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar.

2. Efektet financiare, prej 293 400 000 (dyqind e nëntëdhjetë e tre milionë e katërqind mijë) lekësh, të përballohen, si më poshtë vijon:

a) 101 400 000 (njëqind e një milionë e katërqind mijë) lekë nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë, miratuar për vitin 2017, për zërin “Shpenzimet korrente”, të ndara sipas programeve, përkatësisht, 64 000 000 (gjashtëdhjetë e katër milionë) lekë, në programin buxhetor “Kthimi dhe kompensimi i pronave”; 15 400 000 (pesëmbëdhjetë milionë e katërqind mijë) lekë, në programin buxhetor “Shërbimi i provës”; dhe 22 000 000 (njëzet e dy milionë) lekë në programin buxhetor “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi”;

b) 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë nga buxheti i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, miratuar për vitin 2017, për zërin “Shpenzime korrente”, të ndara sipas programeve, përkatësisht, 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë, në programin buxhetor “Zhvillimi rural, duke mbështetur prodhimin bujqësor, blegtoral, agro-industrial dhe marketingun”, dhe 1 000 000 (një milion) lekë në programin buxhetor “Administrimi i ujërave”;

c) 176 000 000 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë milionë) lekë nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2017.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Drejtësisë për detajimin e fondeve sipas strukturës përkatëse buxhetore dhe përcaktimin e procedurës së dhënies së shpërblimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama**VENDIM****Nr. 2, datë 11.12.2017****PËR MIRATIMIN E LOGOS KOMBËTARE
NË KUADËR TË “VITIT
MBARËKOMBËTAR TË GJERGJ
KASTRIOTIT-SKËNDERBEUT”, SË
BASHKU ME SHKRIMIN “VITI
MBARËKOMBËTAR I GJERGJ
KASTRIOTIT-SKËNDERBEUT-2018”**

Në mbështetje të pikës 4 të vendimit nr. 494, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave për krijimin e Komisionit Shtetëror për organizimin e veprimtarive, në kuadër të “Vitet Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut”, Komisioni Shtetëror për organizimin e veprimtarive, në kuadër të “Vitet Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut”,

VENDOSI:

1. Miratimin e logos kombëtare të Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, e cila paraqitet si një yll me 36 rreze, prej të cilave 6 janë rreze kulmore, me ngjyre të kuqe gjaku, me shqiponjën dykrenore të stemës heraldike të



Kastriotëve me ngjyrë të zezë në qendër, brendashkruar diçiturës “VITI MBARËKOMBËTAR I GJERGJ KASTRIOTT SKËNDERBEUT-2018”, me shkronja kapitale, sipas modelit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Logo shpaloset edhe në dy variante të tjera për t’ju përputhur qëllimeve sociale për të cilat mund të përdoret (modeli nr. 2 dhe nr. 3).

2. Logoja kombëtare e “Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut” përdoret në:

- Dekretet e Presidentit të Republikës;
- Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë;
- Aktet e Këshillit të Ministrave;
- Urdhrat dhe udhëzimet e Kryeministrit;
- Urdhrat dhe udhëzimet e ministrave;
- Urdhrat dhe udhëzimet e titullarëve të institucioneve në varësi të Kryeministrit dhe ministrave;
- Urdhrat dhe udhëzimet e titullarëve të institucioneve në varësi të Kuvendit;
- Vendimet e institucioneve të qeverisjes vendore;
- Urdhrat dhe udhëzimet e titullarëve të institucioneve të qeverisjes vendore;
- Urdhrat dhe udhëzimet e rektoratit të universiteteve;
- Dokumentet e krijuara nga autoritetet publike;
- Veprimtaritë e organizative jofitimprurëse, kur ato zhvillohen në kuadër të “Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut”.

3. Veprimtaritë, shfaqjet vizuale dhe botimet e ndërmarra nga ente private për qëllime fitimprurëse, nuk mund të përdorin logon veçse rast pas rasti, pas miratimit paraprak nga Komisioni Shtetëror të një kërkesë të justifikuar nga objektivi i këtyre veprimtarive, në përputhje me qëllimet e Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut.

4. Uzurpimi apo përdorimi abuziv i logos ndëshkohet sipas ligjeve përkatëse në fuqi.

5. Përmasat e logos në një letër format A4 janë: e lartë 27.5 mm; e gjerë 24 mm; shkrimi “VITI MBARËKOMBËTAR I GJERGJ KASTRIOTT SKËNDERBEUT-2018” vendoset rreth e qark

shqiponjës, dhe është 34 mm i lartë; e 34 mm i gjerë sipas modelit nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Sipas përdorimit mund të ndryshojë ngjyra, përkatësisht (fusha e kuqe-shqiponja e bardhë-shkrimi “VITI MBARËKOMBËTAR I GJERGJ KASTRIOTT SKËNDERBEUT-2018” me shkronja kapitale) dhe (fusha e bardhë-shqiponja e kuqe-shkrimi “VITI MBARËKOMBËTAR I GJERGJ KASTRIOTT SKËNDERBEUT” në anë të djathtë të saj).

6. Logoja të përdoret në posterat dhe ftesat e veprimtarive të rëndësishme shtetërore dhe ndërshtetërore, që do të zhvillohen në kuadër të “Vitit Mbarëkombëtar i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut”.

7. Logoja të përdoret si imazh bazë për konceptimin e shenjave kremtuese, për mirënjohje apo përkujtimore të të gjitha përmasave dhe llojeve, të cilat mund të shërbejnë si elemente dalluese gjatë ceremonive të ndryshme zyrtare, shtetërore dhe ndërshtetërore.

8. Logoja nuk zëvendëson në asnjë rast stemën e Republikës, por përdoret së bashku me të. Logoja, ashtu si dhe stema e Republikës, vendoset në të gjitha aktet zyrtare të sipërpërmendura gjatë gjithë vitit 2018.

9. Logoja, kur paraqitet e shoqëruar me stema shtetesh të tjera, vendoset në një vend të dukshëm, së bashku me stemën e Republikës ose në të njëjtin vend me to.

10. Ngarkohen anëtarët e sekretariatit teknik për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi dhe Këshilli i Lartë i Arkivave për të përfshirë logon në modelet e shkresave zyrtare, duke miratuar ndryshimet përkatëse në vendimin nr. 4, datë 19.6.2017, “Për miratimin e Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KOMISIONIT SHTETËROR

Edi Rama

KRYEMINISTËR



Nr. 1





VITI MBARËKOMBËTAR I
GJERGJ KASTRIOTIT
SKËNDERBEUT



Nr. 3



Nr.4





Model alternativ



VITI MBARËKOMBËTAR I
GJERGJ KASTRIOTIT
SKËNDERBEUT



Model alternativ

VITI MBARËKOMBËTAR I
GJERGJ KASTRIOTIT
SKËNDERBEUT





Model
alternativ

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa: Rr “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel/fax +355 4 24 27 004 Tel +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë